



Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim "Hidromorava" SH.A
Gjilan



Raporti Vjetor për vitin 2021

Shkurt, 2022

Përmbajtja

A. Raporti i Bordit te Drejtoreve

Hyrje.....	4
1.Vizioni, objektivat dhe strategjitë kyqe.....	4
2.Raporti i kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.....	4
2.1.Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrje.....	4
2.2.Aktivitetet e ndërmara gjatë vitit.....	4
2.3.Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Aksionarit.....	4
2.4.Vendimet e Bordit të Drejtorëve.....	5
2.5.Përmbushja e objektivave ligjore.....	6
2.6.Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e kompanisë.....	8
2.7.Një pasqyrë e të priturve në të ardhmen e kompanisë.....	8
2.8.Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendën.....	8
2.9.Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit.....	8
2.10.Investime të bëra gjatë vitit.....	8
2.11.Dividendet e paguara gjatë vitit.....	8
2.12.Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv.....	8
2.12.1.Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve, duke përfshirë kompensimet.....	9
2.12.2.Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit.....	9
2.12.3.Komitetet e bordit, përbërjen e tyre dhe numrin e takimeve të mbajtura.....	10
2.12.4.Raportimet e nevojshme për aksionarin.....	10
2.12.5.Sponsorimet dhe Donacionet.....	10
2.12.6.Raportimet sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike.....	10
2.13.Struktura Organizative e KRU “Hidromorava”-sha.....	10
2.14.Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit.....	12
2.15.Përmbledhja e procedurave gjyqësore.....	12
2.16.Një shqyrtim i performancës afariste dhe financiare gjatë vitit përkatës.....	16
3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv.....	16
3.1.Aktivitetet kontraktuese dhe përfaqëse kryesore.....	17
4. Raport Pune i Departamentit Financiar.....	20
4.1.Pasqyrat e konsoliduara financiare me standardet ndërkombetare të kontabilitetit.....	20
4.2.Fitimi –Humbja e vitit 2021.....	25
5. Progresi me planin e Biznesit dhe vitin paraprak.....	26
5.1.Pasqyrat e implementimit të planit të biznesit dhe raporti krahasues.....	26
5.2.Performanca në raport me vitin paraprak.....	26
5.3.Prodhimi i ujit.....	28
5.4.Faturimi i ujit në m3.....	29
5.5.Faturimi i ujit në €.....	29
5.6.Arkëtimi i ujit në €.....	29
5.7.Përqindja e arkëtimit.....	30
5.8.Shpenzimet në euro.....	30
5.9.Konsumator të regjistruar.....	32

5.10. Konsumator me ujëmatës.....	32
5.11 Konsumatorë me taksë fikse	33
5.12 Konsumator me paushall.....	33
5.13 Numri i faturave të lëshuara.....	34
5.14 Numri i konsumatorëve të rinjë.....	34
5.15 Faturimi i ujit me ujëmatës.....	34
6. Raport pune i Departamentit Teknik.....	35
6.1. Kapaciteti i prodhimit të ujit në burimet të cilat menaxhohen nga KRU “Hidromorava”-sha Gjilan.....	36
6.2. Raporti i prodhimit të ujit dhe faturimi si dhe analiza e UPF-së.....	39
6.3. Cilësia e ujit në zonën e shërbimit në KRU “Hidromorava”-sha.....	40
6.4. Rrjeti i Ujësjiellit dhe Kanalizimit.....	41
6.5. Investimet kapitale gjatë vitit 2021.....	43
7. Raport pune i Departamentit të Prokurimit.....	44

Hyrje

1. Vizioni , Objektivat dhe strategjitë kyqe

Raporti Vjetor është obligim i kompanisë dhe duhet punuar konform Ligjit Mbi Ndërmarrjet Publike , Kodit të Etikës si dhe Udhëzuesit nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndermarrjeve Publike , si ndihmesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për të gjitha Kompanitë e ujërave në Republikën e Kosovës, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqinë RepublikëneKosovës.

Suksesi në veprimtarinë e kompanisë varet nga pajtueshmëria me detyrimet ligjore dhe rregullative, me ndjeshmëri për qështjet lokale dhe angazhim që i jep kontribut pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm të kompanisë .

Prandaj, duke u bazuar në këtë detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara brenda kornizës që është e vendosur nga dy ligje më rëndësi të veçantë për Ndërmarrjet Publike :

- *Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare*
- *Ligji nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe*
- *Ligji nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.*

2. RAPORTI I BORDIT TË DREJTOREVE

2.1.AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

2.2.Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit

2.3.Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Aksionarit

Duke patur parasysh që mbledhja e Përgjithshme vjetore me Aksionarin është pjesa e mekanizmit zyrtar të qeverisjes korporative gjatë së cilës demonstron llogaridhënia për performancën e ndërmarjes dhe rezultateve të vitit të mëparshëm kalendarik Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidromorava”-sha me datë 29.12.2021, ka mbajtur mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin në pajtim me nenin 189. parag.2. të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare.Në këtë mbledhje kanë qënë prezentë z. Besim Imeri Udhëheqës i NJPMNP dhe z.Adem Ahmetaj analist për çështjet e Ndërmarrjeve Publike të Ujësjetës, në NJPMNP-në Ministrinë e Ekonomisë.

Gjatë mbledhjes së përgjithshme me aksionarin janë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës:

a). Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së përgjithshme vjetore me aksionarin të mbajtur më 15.09.2020.

- b). Miratimi i Raportit të Auditorit për pasqyrat financiare të auditimit për vitin 2020 dhe letrës për menaxhmentin dërguar nga zyra kombëtare e auditimit;*
- c). Miratimi i Raportit Vjetor 2020;*
- d). Performanca e Menaxhmentit të Kompanisë.*

2.4.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bord, gjithmonë është bërë në mënyrë demokratike dhe të lirë duke e rrespektuar të drejtën e lirë dhe pa presione të votimit dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Duke u bazuar në këtë Bordi i Drejtorëve gjatë periudhës raportueseka marrë këto vendime:

-Vendimi: 1/2021

- Miratimi i Raportit të parë të Komisionit të Auditimit për vitin 2021, në mbledhjen e parë të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 03.02.2021.

-Vendimi : 2/2021

-Miratimi i raportit për tremujorin e katërt (IV) për vitin 2020 të punës së Ekzekutivit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 25.02.2021.

-Vendimi : 3/2021

Miratimi i raportit vjetor për vitin 2020, përmes postës elektronike me datë 10.03.2021.

-Vendimi : 4/2021

-Miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2020, përmes postës elektronike me datë 17.03.2021

-Vendimi : 5/2021

-Miratimi i provizionimit të borxheve në vlerë prej 71,652.71 euro për vitin 2020, përmes postës elektronike me datë 19.03.2021.

-Vendimi : 6/2021

-Miratimi i Raportit të kënaqshmërisë së konsumatorëve për vitin 2020 , në mbledhjen e tretë (III) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 30.03.2021.

-Vendimi: 7/2021

-Miratimi i Raportit të dytë (II) të komisionit të auditimit për vitin 2021 , në mbledhjen e katërt (IV) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 29.04.2021.

-Vendimi: 8/2021

-Miratimi i raportit për tremujorin e parë për vitin 2021 të punës së Ekzekutivit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 28.05.2021.

-Vendimi: 9/2021

-Miratimi i raportit të III të Komisionit të Auditimit për vitin 2021, në mbledhjen e shtatë (VII) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 04.08.2021.

-Vendim: 10/2021

-Miratimi i Raportit i raportit të zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2020, në mbledhjen e shtatë (VII) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 04.08.2021.

-Vendimi 11/2021

-Miratimi i Vetë-vlerësimit të Bordit të Drejtorëve për vitin 2020, në mbledhjen e shtatë /7/ të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 04.08.2021.

-Vendimi: 12/2021

- Miratimi i raportit të tremujorit të dytë (II) për vitin 2021 të punës së ekzekutivit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 31.08.2021.

-Vendimi : 13/2021

--Miratimi i Raportit të /IV/ të Komisionit të Auditimit për vitin 2021, në mbledhjen e dhjetë (X) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 29.10.2021.

-Vendimi : 14/2021

- Miratimi i planit të biznesit për vitin 2022-2024 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 29.10.2021.

-Vendimi : 15/2021

-Miratimi i Raportit për tremujorin e tretë (III) për vitin 2021 të punës së Ekzekutivit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 30.11.2021.

2.5.Përmbushja e objektivave ligjore

Me synim të përmbushjes së objektivave dhe politikave zhvillimore të vendosura nga aksionari, për të drejtuar kompaninë drejt suksesit , Bordi i Drejtorëve në mënyrë efikase dhe kolegjiale si ekip në suaza të kornizës ligjore dhe rregullatore gjatë vitit 2021 ,ka përmbushur obligimet ligjore për raportime të rregullta që burojnë nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Raporti i tre mujorit të Katërt i vitit 2021 i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 04.02.2022, me të cilin rast janë dhënë shpjegimet e aktiviteteve të ndërmarrjes në fushën operacionale, aktivitetet investuese, arritjet e të gjitha departamenteve, njësive të biznesit dhe ndryshimet/zhvillimet në strukturën organizative, të dhënat operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyra financiare tremujore krahasuar me vitin paraprak dhe aktivitetin e zyrës ligjore dhe rastet e padive në gjykatë.

Raporti vjetor për vitin 2020- është miratuar nga Bordi i Drejtorëve 10.03.2021, përmes postës elektronike në afatin e paraparë ligjor në përputhje me nenin 31 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ,si raport gjithpërfshirës për aktivitetet e kompanisë dhe performancën përgjatë vitit paraprak ,gjithashtu në të janë dhënë përmbledhje të

arritjeve operacionale të kompanisë për secilën njësi veçmas, Raporti Vjetor ka siguruar që me vlerësimet e ekuilibruara dhe të kuptueshme lidhur me performancën e Kompanisë të paraqesë në fund të vitit gjithashtu edhe perspektivat e saja në të ardhmen .

Raporti i Tre mujorit të parë për vitin 2021 i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 28.05.2021, me të cilin rast janë dhënë shpjegimet e aktiviteteve të ndërmarrjes në fushën operacionale, aktivitetet investuese, arritjet e të gjitha departamenteve, njërive të biznesit dhe ndryshimet/zhvillimet në strukturën organizative, të dhëna operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyra financiare tremujore krahasuar me vitin paraprak dhe aktivitetin e zyrës ligjore dhe rastet e padive në gjykatë.

Auditimi i Pasqyrave Financiare- Auditimi i pasqyrave financiare per vitin 2021, është kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit konform Ligjeve aktuale në fuqi auditimi ka përfunduar sipas afatit të përcaktuar duke u bazuar në këtë Bordi i Drejtorëve më 04.08.2021, ka miratuar Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe pasqyrat e përgaditura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin 2020.

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për KRU “Hidromorava” Sh.A.Gjilan për vitin 2020 jep opinion të kundërt për pasqyrat financiare vjetore.

Baza për opinion e dhënë nga auditorët ” Sipas opinionit, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin “Baza për opinion të kundërt”, pasqyrat financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Hidromoravës deri më 31.12.2020, të performancës së saj financiare , si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2020, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNFR)

Raporti i Tre mujorit të Dytë për vitin 2021 i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 31.08.2021, si dhe Raporti i Tre mujorit të Tretë për vitin 2021 i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit që është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 30.11.2020, ku janë dhënë shpjegimet e aktiviteteve të ndërmarrjes në fushën operacionale, aktivitetet investuese, arritjet e të gjitha departamenteve, njërive të biznesit dhe ndryshimet/zhvillimet në strukturën organizative, të dhëna operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyra financiare tremujore krahasuar me vitin paraprak dhe aktivitetin e zyrës ligjore dhe rastet e padive në gjykatë.

Plani i Biznesit 2022-2024 -është miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 29.10.2021, dhe paraqesin objektiva të karta dhe është një dokument përmbledhës i përbërë nga tri njësitë e biznesit me argumentimet përkatëse.

Shënim: Raporti Vjetor dhe Raportet tre-mujore në formë të informatës i janë dërguar edhe kryetarëve të Komunës së Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë , pasi që në këto komuna kompania jonë ushtron veprimtarinë e saj dhe e tërë kjo konform nenit 31 paragrafi 6 i Ndryshimi dhe plotësimi dhe Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nr.04/L-111 .

2.6.Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmën e ndërmarrjes

Ajo që është më e rëndësishme për të ardhmen e ndërmarrjes aktualisht është që, ndërmarrja të vazhdojë të monitorohet nga qendra përmes Bordit të Drejtorëve për të vazhduar një qeverisje e mirë . Kjo nënkupton një kontinuitet në qeverisje me së paku 50% të stafit menaxhues të tanishëm , sepse mendojmë që është arritur një performancë pozitive në krahasim me vitet e mëhershme , por gjithmonë duke ditur që nuk ka vënd për vetëkënaqësi në këtë drejtim.

2.7.Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

- a) Shtimi i kapaciteteve të ujit
- b) Rritja e inkasimit
- c) Zvoglimi i humbjeve të ujit
- d) Rritja e Faturimit
- e) Eliminimi i faturimeve dhe pagesave paushalle
- f) Faturimi i punëve që kryhen nga kompania për palët e treta
- g) Arritja e caqeve në Planin e Biznesit

2.8.Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën

Në pasqyrat financiare shihet se edhe përkundër rritjes së rezultatit operativ, para zhvleftësimit, kompania afaron me fitim , kështu që Humbja është- 36,350.00€.

2.9.Kredite e rëndësishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit (nuk ka).

2.9.Kredite e rëndësishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit (nuk ka).

2.10. Investime te rëndësishme gjatë vitit kemi pasur në vlerë prej 73,188 **euro**- Investime ne vijim rehabilitim te rrjetit , pompa, kompjutera, inventar , kamera ,laptopa , paisje per zyre, gypa etj) ne vlere prej 23,447 **euro** .

2.11.Dividendet e paguara gjate vitit(nuk ka)

2.12. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

2.12.1. Emrat e drejtoreshave të bordit të drejtoreshave, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes .

Në mbështetje të nenit 92. Paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15. Të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe të nenit 4. Paragrafi (3) të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr.01/2007, Qeveria e Kosovës pas një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ekskluzivisht në bazë të meritave, për KRU "Hidromorava" Sh.A.-Gjilan më datë 30.10.2015 merr vendimin nr.12/56 mbi formimin e Bordit të Drejtorëve në këtë përbërje:

- Znj. Elhame Shefkiu - Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
- Z. Ali Arifi - Kryesues i Komisionit të Auditimit
- Z. Avdyll Hasani-Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- Z. Xheladin Zenuni - Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- Z. Xhemajl Aliu - Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- Znj. Ariana Pireva - Anëtare e Bordit të Drejtorëve

Në KRU "Hidromorava" SH.A kompensimet për Drejtorët, që nga fillimi i emërimit të BD e deri me raportimin , është bërë konform Vendimit Nr.12/56 datë: 30.10.2015 - Mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore sipas kategorizimit të vendosur nga Akcionari- Qeveria e Kosovës .

Nr.	Emri e Mbiemri	Pozita	Kompensimi		
			BD	KA	
1.	Elhame Shefkiu	Kryesuese e Bordit të Drejtorëve	450 €		
2.	Ali Arifi	Kryesues i Komitetit të Auditimit	320 €	110€	430€
3.	Avdyll Hasani	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	320 €	80€	400 €
4.	Xheladin Zenuni	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	320 €	80 €	400 €
5.	Xhemajl Aliu	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	320 €		
6.	Ariana Pireva	Anëtare e Bordit të Drejtorëve	320 €		

2.12.2. Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e Bordit

Gjatë vitit 2021, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe kryerjes së detyrave të tij në mënyrë sa më

efikase ,Bordi i Drejtorëve gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta. Pjesëmarrja e Drejtorëve ka qënë gjithmonë e plotë sepse paraprakisht para caktimit të mbledhjeve ka pasur dakordim të plotë për kohën e mbajtjes së tyre.

2.12.3. Komitetet e bordit, perberjen e tyre dhe numrin e takimeve të mbajtura

Nëmbështetjet e nënitetit të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për KRU "Hidromorava" Sh.A.-Gjilan, me Vendimin e saj nr. 2767 të dt. 23.11.2015 e cakton Komisionin Auditimit në kuadër të Bordit të Drejtorëve nëpërbërje prej:

- Z. Ali Arifi - kryesues
- z. Avdyll Hasani - anëtar
- z. Xheladin Zenuni - anëtar .

Bordi i Drejtorëve në KRU "Hidromorava" e ka të funksionalizuar vetëm Komisionin e auditimit i cili gjatë vitit 2021 ka mbajtur katër (4) mbledhje të rregullta , gjatë të cilave janë shqyrtuar qështje thelbësore të afarizmit të kompanisë para shqyrtimit dhe miratimit në Bord të Drejtorëve . Ndërsa komitete të tjera , qoftë të përkohshme apo të përhershme nuk janë themeluar për shkak se Bordi i Drejtorëve nuk ka pasur të nevojshme t'i ketë komitete tjera.

2.12.4. Raportimet të cilat janë të nevojshme për aksionarin

2.12.5. Sponzorimet dhe donacionet gjatë vitit 2021

Kompania gjatë vitit 2021 ka vazhduar të mbështetet me financimin e projekteve që kanë qënë dhe kanë vazhduar në vitin 2021 në vlerë prej 21 191 EUR nga Komuna e Gjilanit.

2.12.6. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

2.13. Struktura organizative e KRU "Hidromorava" Sh.A.

Një prej faktorëve që esencialisht ndikon në performancën dhe zhvillimin efikas të kompanisë është potenciali njerëzor që është resursi më i meritues në menaxhimin veprimtarisë me plotë përgjegjësinë për mbushjen e qëllimit në drejtim të funksionimit të kompanisë.

KRU "Hidromorava" Sh. A ka përgatitur strukturën organizative e cila përputhet me strategjinë zhvillimore sepse rolet dhe përgjegjësitë janë të specifikuar mirë. Struktura e përgatitur ka prodhuar efikasitet në perspektivën e menaxhimit të kompanisë.

Prandaj , gjatë periudhës raportuese për vitin 2021 Menaxhmenti i KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, nuk ka pasur asnjë rast të rekrutimit të punëtorëve të plotësisht të stafit e as angazhimit të punëtorëve me kontratë mbi vepër.

Gjatë kësaj periudhe raportuese në KRU "Hidromorava"-sha në Gjilan, punëtorëve Hesat Pira, Azem Lakna, Kujtim Ahmeti, Abdulla Kurteshi të njejtëve i është ndërprerë Kontrata e Punës pasi që të punësuarit kanë mbushur moshën e pensionit prej 65 vjeç, konform nenit 67.të Ligjit të Punës në Kosovë.

Kështu që aktualisht KRU" Hidromorava" Sh.A operon me 155 punëtorë në regjion në Gjilan 118, Viti 20 dhe Kamenicë 17 punëtorë i ndarë në shërbimin Administrativ, Finansiari dhe Teknik.

KRU"Hydromorava Sh.A. ka këtë strukturë të të punësuarve:




Fig.1 Struktura nëpër njësi

Nga figura e mësipërme kuptohet se nga të punësuarit e teresishem 118 ose 73% e punëtorëve janë në Gjilan, 20 ose 14% punëtorë në njësinë e Vitisë ,dhe 17 ose 13% e punëtorëve janë përfshirë në njësinë e Kamenicës.




Fig.2. Struktura Gjinore

Nga figura e mësipërme kuptohet se nga të punësuarit e terësishëm 131 ose 85,63 % e punëtorëve janë meshkuj dhe 24 ose 14,37% e punetoreve jane femra.Kjo strukturë në të ardhmen mendohet të ndryshohet në të mirë të rritjes së të punësuarëve të gjinisë femrore.

Fig. 3. Struktura e kualifikimit shkollor




Figura e mësipërme jep strukturën e të punësuarve sipas përgaditjes shkollore. Nga numri i tërësishëm, 17 ose 11.12 % e punësuarve kanë përgaditje të lartë superiore, 20 ose 5.88 % kanë përgaditje Bachelor dhe shkolle të lartë, 93 ose 56.86 % e të punësuarve kanë përgaditje të mesme shkollore, dhe 29 ose 26,14 % e të punësuarve kanë përgaditje të ulët shkollore.

2.14. Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

Riorganizimi i punës, transferimi i punëtorëve në shërbime të planifikuara, ndryshimet e vazhdueshme strukturore që kanë si synim fleksibilitet më të madh në punë dhe përshtatje me mjedisin e punës janë treguesit kryesor që trajnimi dhe zhvillimi stafit të jetë një proces i vazhdueshëm me ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit të kompanisë së KRU “Hidromorava” SH.A. përmes këtij procesi synohet të arrihet një përmirësim i aftësive dhe një kualifikim profesional i punëtorëve, sepse çdo punë ka specifikat e veta.

Nevojat e trajnimeve janë evidente si në menaxhment ashtu edhe në sektorët financiar, teknik dhe administrativ ku trajnimi është i nevojshëm për njohjen e rregullativit në fuqi me qëllim që të mos bien ndesh me Ligjin.

2.15. Një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në;

2.15.1. Me datë 02.02.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan-departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, është pranuar Aktgjykimi P.nr. 964/19 i dt. 26.10.2021 me të cilën i pandehuri Sadri Fetinci nga Gjiilani, është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6. Lidhur me nenin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2.15.2. Me datë 02.02.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan-departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, është pranuar Aktgjykimi P.nr. 1054/2020 i dt. 20.01.2021 me të cilën i pandehuri Shkëlzen Gashi nga Gjiilani, është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale

vjedhje nga neni 313. Paragrafi 1. Lidhur me nenin 77. Të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2.15.3. Me datë 11.02.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, është pranuar Aktvendimi CPK nr.185/19 dt. 24.12.2020, me të cilin i është refuzuar prapësimi i debitorit Bashkim Nexhipi nga Gjiilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarrimor i përmbarruesit privat P.nr.305/19 i dt.28.06.2019 për shkak të borxhit të debitorit në lartësi prej 1.540,14 €.

2.15.4. Me datë 11.02.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan , është pranuar Aktgjykimi C.nr. 472/2016 i dt. 11.01.2021, me të cilin i është refuzuar si e pa bazuar kërkespadija e paditësve Naime Sylaj, Driton Sylaj, Ardita Dërvodeli për shkak të borxhit në shumë prej 1.045,40 €.

2.15.5. Me datë 23.02.2021 nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.2750/2020 të dt. 28.01.2021, i është refuzuar si e pa bazuar ankesa e debitorit Jakup Stublla nga Gjiilani, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan CPK.nr. 171/18 , P.nr.661/18 i datës 10.03.2020 Vërtetohet, për shkak të borxhit në shumë prej 2.110,44 €.

2.15.6. Me datë 04.03.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, është pranuar Aktvendimi CPK nr.193/19i dt. 24.12.2020, me të cilin i është refuzuar prapësimi i debitorit N.T.P.” I-Bimi”-Gjiilan, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarrimor i përmbarruesit privat P.nr.848/18 i dt. 26.12.2018 për shkak të borxhit të debitorit në lartësi prej 556,25 €.

2.15.6. Me datë 25.03.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, është pranuar Aktvendimi CPK nr.261/19 i dt. 16.03.2021, me të cilin i është refuzuar prapësimi i debitorit Isa Shurdhani nga Gjiilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarrimor i përmbarruesit privat P.nr.532/19 i dt. 06.12.2019, për shkak të borxhit të debitorit, në lartësi prej 1.026,17 €.

2.15.7. Me datë 23.02.2021 nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.5232/2020 të dt. 25.02.2021, i është refuzuar si e pa bazuar ankesa e debitorit Kujtim Sylja nga Gjiilani nga Gjiilani, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan CPK.nr. 187/19 , i datës 06.04.2020 Vërtetohet, për shkak të borxhit të debitorit në shumë prej 1.111,01 €.

2.15.8. Me datë 25.03.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan-departamenti i Përgjithshëm , Divizioni Civil, është pranuar Aktvendimi C.nr.1565/20 i dt. 04.03.2021, me të cilin i është hudh poshtë si e pa lejuar padia e paditësit Adem Mustafa nga Gjiilani e paraqitur kundër të paditurës KRU “Hidromorava”-sha Gjiilan, lidhur me parashkrimin e kërkesës në të holla.

2.15.9. Me datë 352 të dt. 27.04.2021 nga Gjykata Themelore në Gjiilan- dega në Kamenicë, është pranuar Aktgjykimi P.nr. 171/19 i dt. 12.04.2021 me të cilin i pandehuri Naim Demolli nga Kamenica, është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale ndotja e ujit të pijshëm nga neni 264. Paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. dhe 77. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës duke i shqiptuar dënim me gjobë (në të holla) në vlerë prej 1.000 euro.

2.15.10. Me datë 07.05.2021 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, është pranuar

Aktvendimi Ac.nr.2733/2020 i dt. 16.04.2021, me të cilën kjo gjykatë ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e debitorit Xhemail Ramizi nga Gjilani, duke vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan CPK nr.80/19 të dt. 12.03.2020, për shkak të borxhit 3.624,10 euro.

2.15.11. Me datë 31.05.2021 nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, është pranuar Aktvendimi Ac.nr.3351/2020 i dt. 28.04.2021, me të cilën kjo gjykatë ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e debitorit Naser Maliqi nga Kamenica, duke vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Kamenicë PPP nr.7/2020 të dt. 25.06.2020, për shkak të borxhit 1.542,85 €.

2.15.12. Me datë 02.06.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar Aktvendimi për aprovimin e prapësimit të pjesshëm të debitorit Afrim Mehmeti nga Gjilani, me të cilën nga borxhi total prej 2.389,82, të njejtit i është parashkruar borxhi prej 2.109.39 €, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit është në vlerë prej 280.49 €, kundër këtij Aktvendimi kreditori KRU “Hidromorava”-sha ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.15.13. Me datë 09.06.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan,-Dega në Viti -Departamenti i Përgjithshëm, është pranuar Aktvendimi PPP nr.75/20 i dt. 31.05.2021, me të cilin hudhet poshtë si i pa lejuar prapësimi i debitorit Raif Emërllahu nga Vitia, duke mbetur në fuqi urdhëri i lejuar i përmbaruesit privat P.nr. 362/2020 i dt.16.10.2020, për shkak të borxhit të debitorit, në lartësi prej 2.189.63 € që ka ndaj kreditorit KRU” Hidromorava”sha Gjilan..

2.15.14. Me datë 15.06.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.168/2018 i dt. 08.06.2021, me të cilën i është refuzuar si pa bazuar prapësimi i debitorit Selim Abazi nga Gjilani duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarim i Përmbaruesit Privat P.nr. 657/18 i dt. 22.11.2018, për shkak të borxhit në vlerë prej 1243.92 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU “Hidromorava”-sha Gjilan, kundër këtij Vendimi debitori ka ushtruar Ankesë ne Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.15.15. Me datë 25.03.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti i Përgjithshëm , Divizioni Civil, është pranuar Aktvendimi C.nr.1565/20 i dt. 04.03.2021, me të cilin i është hudh poshtë si e pa lejuar padia e paditësit Adem Mustafa nga Gjilani e paraqitur kundër të paditurës KRU “Hidromorava”-sha Gjilan, lidhur me parashkrimin e kërkesës në të holla.

2.15.16. Me datë 15.06.2021 nga Gjykata e Apelit në Prishtinë , është pranuar Aktvendimi Ac.nr.4474/20 i dt. 17.05.2021 me të cilën është hudhë ankesa e debitorit Isah Maloku nga Gjilani, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan CPK, nr. 106/18 i dt. 04.08.2020 si e PA AFATËSHME, për shkak të borxhit prej 728.34 euro, që ka debitori ndaj kreditorit.

2.15.17. Me datë 15.06.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar Aktgjykimi C.nr. 450/2021 i dt. 04.06.2021, me të cilën Refuzohet në terësi kërkespadija e paditësit-punëtorit Metush Bajrami, me të cilën ka kërkuar që ta obligoj të paditurën KRU “Hidromorava”-sha Gjilan, të paguajë kompenzimin për shpërblimin jubilar në vlerë prej 440.00 euro, kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2.15.18. Me datë 15.06.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar Aktgjykimi C.nr. 448/2021 i dt. 03.06.2021, me të cilën Refuzohet në terësi kërkespadija e paditësit-punëtorit Sadik Kosumi, me të cilën ka kërkuar që ta obligoj të paditurën KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, të paguajë kompenzimin për shpërblimin jubilar në vlerë prej 957.00 euro, kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2.15.19. Me datë 12.08.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar Aktvendimi CPK nr.13/18 dt. 23.07.2021 për aprovimin e pjesëshëm të prapësimit të debitorit Afrim Mehmeti nga Gjilani, me të cilën nga borxhi total prej 1,005.51 euro, të njejtit i është parashkruar borxhi prej 644,64 €, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit është në vlerë prej 360,87 €, kundër këtij Aktvendimi kreditori KRU "Hidromorava"-sha ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.15.20. Me datë 12.08.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.101/2021 i dt. 26.07.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Zyrafete Jashari nga Gjilani duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat P.nr. 324/18 i dt. 28.06.2018, për shkak të borxhit në vlerë prej 702,77 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, kundër këtij Vendimi debitori ka ushtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.15.21. Me datë 12.08.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.209/19 i dt. 25.06.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Isuf Mehmeti nga Gjilani duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat P.nr. 315/18 i dt. 28.06.2018, për shkak të borxhit në vlerë prej 1,457.06 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, kundër këtij aktvendimi debitori ka ushtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.15.22. Me datë 19.08.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.121/19 i dt. 11.08.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Rrahim Ismajli nga Gjilani duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat P.nr. 47/18 i dt. 09.01.2018, për shkak të borxhit në vlerë prej 3,579,09 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

2.15.23 Me datë 13.10.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.123/2021 i dt. 11.10.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Rabbit Fazliu nga f.Zhegër duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat P.nr. 165/21 i dt. 28.06.2021, për shkak të borxhit në vlerë prej 378.00 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

2.15.24. Me datë 13.10.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.19/2021 i dt. 20.08.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Sebush Emmini nga Gjilani, trahëgimtar i të ndjerit Mehmet Emmini, duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat P.nr. 45/2020 i dt. 22.01.2020, për shkak të borxhit në vlerë prej 3,520.56 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

2.15.25. Me datë 19.11.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi

CPK.nr.117/2021 i dt. 21.10.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Emin Osmani nga Gjilani, duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarim i Përmbaruesit Privat P.nr. 141/2021 i dt. 22.06.2021, për shkak të borxhit në vlerë prej 1,085.40 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

2.15.26. Më datë 19.11.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar aktvendimi CPK.nr.119/2021 i dt. 21.10.2021, me të cilën i është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Veli Sermaxhaj nga Gjilani, duke mbetur në fuqi urdhëri për përmbarim i Përmbaruesit Privat P.nr. 243/2021 i dt. 29.06.2021, për shkak të borxhit në vlerë prej 946.28 €, që i ka debitori ndaj kreditorit KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

2.15.27. Me datë 21.12.2021 nga Gjykata Themelore në Gjilan, është pranuar Aktvendimi CPK nr.174/21 dt. 21.12.2021 për aprovimin e pjesëshëm të prapësimit të debitorit Bari Zahiri nga Gjilani, me të cilën nga borxhi total prej 2,190.50 euro, të njejtit i është parashkruar borxhi prej 2.006.26 €, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit është në vlerë prej 184,24 €, kundër këtij Aktvendimi kreditori KRU "Hidromorava"-sha ka parashtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

2.16. Një shqyrtim të performancës afariste dhe financiare gjatë vitit përkatës;

- Paratë në arkë 487,825€
- Fitimi(humbja) -36,350€
- Ekuiteti aksionar, rezervat dhe detyrimet janë 7146,937 €
- Zhvleftësimi I mjeteve është bërë sipas kategorivete percaktuara me standadre të kontabilitetit

3. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv sa i përket periudhës raportuese ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të kompanisë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava" –sh.a. Gjilan.

Pa dyshim, në këtë periudhë të raportimit sfida kryesore për kompaninë ka qenë dhe mbetet rritja e inkasimit si dhe zvoglimi i ujit të pafaturuar. Gjat kësaj periudhe edhe përkundër vështërsive të shumta kemi patur angazhim së daljes në teren me ekipet e çkyqjes dhe është arritë një rezultat në drejtim të inkasimit të borxheve përmes përmbaruesit privat duke vepruar konform procedurave të çkyqjes të percaktuara me rregullat e kompanisë të cilat janë miratuar nga Bordi I Drejtorëve dhe në koordinim me Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

Shkalla e humbjeve të ujit si dhe shkalla e ulët e arkëtimit të faturave vazhdojnë të jenë pikat e dobëta të performancës dhe njëkohësisht pengesa kryesore për qëndrueshmërinë

financiare të kompanisë, performanca në këta dy tregues mbetet ende sfidë për kompaninë në zgjidhjen e këtyre problemeve, edhe përkundër faktit se në këtë periudhë raportuese jemi ballafaquar me përhapjen e pandemisë COVID-2019.

Nuk ka dyshim se reduktimi i humbjeve të ujit dhe ngritja e shkallës së arkëtimit janë sfida kryesore dhe si të tilla duhet të trajtohen si prioritete kryesore ku angazhimi ka qenë maksimalisht i ngritur në këtë drejtim me gjithë potencialin vetëm e vetëm që të dilet nga problemet e shfaqura drejtë zgjidhjes së tyre, duke u bazuar në Strategjinë për zvoglimin e humbjeve të ujit.

Mirëpo edhe përkundër vështërsive lidhur me inkasimin që është brenga e jonë kryesore me krijimin e ekipeve të çkyqjes të angazhuar në çdo zonë si mekanizëm efikas për adresimin e problemit të arkëtimit kemi patur ngritje të lehtë pozitive në këtë plan të cilin angazhim nuk e kemi ndërprerë jemi duke e vazhduar me ritëm të caktuar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese jemi fokusuar në një mbikqyrje më të madhe në të gjithë sektorët punues konform aktiviteteve të ushtruara si në leximin e rregullt të ujëmatësve që kemi mangësi, efikasitetin e shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sigurimin dhe montimin e ujëmatësve për konsumatorët me paushall, në defektimin e rrjedhjeve etj.

Brenga sfiduese për ne duke përfshirë njësitë operuese Gjilanin, Kamenicën dhe Vitinë është performanca e dobët e operimit për shkak të rritjes së shpenzimeve sidomos për njësinë e Kamenicës dhe Vitisë nga arsyea e reflektimit të mos zvoglimit të shpenzimeve, duke përjashtuar njësinë e Gjilanit e cila njësi ka trend pozitiv si në inkasim ashtu edhe në zvoglimin e shpenzimeve, tani shpenzimet e energjisë elektrike gjat sezonës së dimrit janë në rritje e sipër, mirëpo mbi këtë bazë ne nuk do të dorëzohemi fokusi do të jetë që të mos rriten shpenzimet kështu që nga Ekzekutivi lypset angazhim edhe më i madh që këto dukuri të evitohen në të ardhmen për të mirën e kompanisë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Pra, i gjithë fokusi gjatë kësaj periudhe është bazuar në indikatorët e shprehur si në rritjen e inkasimit, zvoglimin e shpenzimeve, në zvoglimin e humbjeve të ujit, në leximin me kohë të ujëmatësve, në zvoglimin e numrit të konsumatorëve me takes fikse, paushallit dhe në aktivitete tjera. Pra, për kompaninë tonë sfiduese do të jetë transparenca, besueshmëria dhe partneriteti që njihërit kjo është edhe motoja e jonë.

3.1. Aktivitetet kontaktuese dhe përfaqësuese kryesore

Me qëllim të permbushjes së karakterit publik të kompanisë, menaxhmenti ka realizua një varg aktivitetesh të kontakteve me akter të jashtëm dhe komunal me ndikim në afarizmin e kompanisë.

➤ Kontaktet me organet e pushtetit lokal :

Kryeshefi Ekzekutiv gjatë kësaj periudhe raportuese është takuar si me subjekte fizike dhe përfaqësues të subjekteve juridike duke i cekur ato me rëndësi për kompaninë si në vijim;

3.1.1. Takim pune me Drejtorin e Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit, në lidhje me organizimin e punëve të sistemit të ujësjellësit për f.Bilinicë,Livoq të epërm, Vërbicë të Kmetocit.

3.1.2. Takim pune me shtabin e emergjencës për Vërshime, ku jemi koordinuar me Drejtorin Komunal për mbrojtje dhe shpëtim dhe drejtorit tjera, duke e menaxhuar bashkarisht situatën e krijuar, vlerësimin e dëmëve e ka bërë komisioni komunal.

3.1.3. Takimpune me Taskë-forcën për menaxhimin e thatësisrës, ku kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e taskë-forcës, është analizuar situata pas të rreshurave të shiut duke përfshirë kuotën maksimale të nivelit të arritur në 30,30 m dhe është aktivizuar kapërderdhja te Penda e Pëerlepnicës.Taska forca ka hequr gjendjen emergjente të thatësisë pasi që është stabilizuar furnizimi me ujë.

3.1.4. Takim me Kryetarin e Komunës së Vitisë dhe përfaqësuesin e Dorsch-CDI në lidhje me finalizimin e punëve në rrjetin e ujësjellësit për zonat rurale të dy f.Sadovina, dy f.Sllatinave, Terstenik, Smirë, Vërban, Zhiti, Skifteraj, Beguncë dhe Kabash.

3.1.5. Ndëgjim Publik me përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit dhe pronarëve të parcelave në f.Uglarë, me rastin e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.

3.1.6. Takimpune me Kryetarin e Komunës së Vitisë dhe përfaqësuesin e Dorsch z.Allan Brown në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes për investime të përbashkëta në mes Komunës dhe Dorsch-it.Pas përfundimit të punimeve të rrjetit të ujësjellësit do të formohet komisioni nga KRU” Hidromorava” me ç’rast do të bëhet pranimi teknik dhe pas pranimi teknik Hidromorava do t’i merr në menaxhim.

3.1.7. Takim me Nënkryetarin e Komunës së Kllokotit dhe përfaqësuesin e CDI-së Astrit Vokshin në lidhje me vazhdimin e investimeve në Kllokot, ku Komuna e Kllokotit i ka obligim KEDS-it mbi 40.000 euro borxh, dhe ja kanë ndërprerë rrymën në stacionin e pompave. Nënkryetari i Komunës së Kllokotit u zotua që do t’i kryen obligimet ndaj KEDS-it, poashtu edhe përfaqësuesi i CDI-së u zotua se do të investojnë në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit.

3.1.8. Takim pune me Kryetarin e Komunës së Vitisë dhe përfaqësuesin e CDI-së në lidhje për marrjen e tri /3/ fshatrave në menaxhim Skifteraj, Beguncë dhe Zhiti, të cilat nuk i kemi marrë në menaxhim pasi që akoma nuk është bërë pranimi teknik.

➤ **Kontaktet me organet e Pushtetit Qëndrorë dhe Shoqatat Rajonale:**

3.2.1. Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për organizimin e punëve me Bankën Botërore , lidhur me marrëveshjen e financimit “Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për programin e sigurisë së ujërave”, programi “FLOËS” adresimi i bazës ujore me investime kapitale.

3.2.2. Takim në Ministrinë e Ekonomisë ku kanë marrë pjesë tri /3/ ministri, Ministrja e Ekonomisë, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministri i Mbrojtjes, pastaj Njësi i monitorimit e ndërmarrjeve publike dhe shtatë /7/ kompanit regjionale të ujësjellësit lidhur me sigurisë së furnizimit me ujë nga KRU-të, mbulueshmëria me furnizim me ujë dhe rreth nevojave të reja për furnizim me ujë nga KRU-të.Gjatë këtij takimi unë ja kam dorëzuar

në kopje fizike projekt propozimet e KRU "Hidromorava"-sha për investime afatmesme dhe afatgjate duke i njoftuar për gjendjen e furnizimit me ujë, mbulueshmërinë dhe nevojat të reja për furnizim me ujë.

3.2.3. Takim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me temën "Planifikimi i digave akumuluese dhe menaxhimi i ujërave në përgjithësi", duke kërkuar që të investohet në studimin e fizibilitetit të "Shushtë" dhe të lumi "Llapushnicë", pastaj të bëhet hartimi i projektit dhe ekzekutimi i punëve për shkak se Komuna e Gjilanit çdo katër /4/ vite prej pas luftës nuk është bërë matja e digës të Penda e Përlepnicës ku duhet të bëhet matja e trupit të Pendës.

3.2.4. Takim pune në FPU "Shkabaj" në KRU "Prishtina, me Këshillin ndërministror për ujëra, IKSHP, ARRU-ja, përfaqësuesi i Njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, Kryeshefat Ekzekutiv të shtatë kompanive ujore dhe përgjegjësat për kualitet të ujit, në këtë takim është diskutuar problemi i ujit të pijshëm që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit dhe janë prezentuar gjetjet të IKSHP-së për rastin e Deçanit-mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për KRU-të për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

3.2.5. Takim pune menaxhmenti i KRU "Hidromorava"-sha me përfaqësuesit e ARRU-së, lidhur me tarifën ku i kemi prezentuar të gjithë indikatorët që ndikojnë në rritjen e shpenzimeve e kemi ngritur këtë çështje pasi që janë ngritur çmimet e artikujve po ashtu pritjet të ngritet edhe çmimi i energjisë elektrike.

➤ **Kontaktet me donatorë:**

3.3.1. Takim pune me KFOR-in turk, në lidhje me furnizimin me ujë për pesë /5/ Komunat, Gjilan, Viti, Kamenicë, Ranillug, dhe Novo Bërd si dhe për gjendjen e pandemisë Covid-19 se si është menaxhuar furnizimi me ujë. Poashtu është diskutuar për burimet e ujit pasi që kemi qenë në gjendje emergjente të thatësirës, i kam njoftuar edhe për menaxhimin e pandemisë covid-19 dhe gjendjen emergjente të thatësisë përkitazi me furnizimin me ujë.

